




Raporti Vjetor
Annual Report
2012





Në mesin e përkrenares është vendosur një rreth prej bakri, ku dallohen këto shkronja: I.N.P.E.RA.TO.BE. BT. Ky shkrim, deri tani është deshifruar kështu: *Jesus Nazarenus Principi Emathiae. Regi Albaniae. Terrori Osmanorum. Regi Epiri. Benadicat*". Poshtë buzës së përkrenares janë vënë 9 copa të mëdha dhe këto janë të lidhura me një rrip bojë hiri. Pesha e të gjithë përkrenares është 3 kg.

Njëra shpatë është e gjatë 88.5cm dhe e gjerë 5.7 cm, me dy tehe, me një formë të drejtë ku lexohen këto fjalë: *"Heroi i Perëndisë, Iskander Beg"*. Doreza është prej druri, e mbështjellë me lëkurë. Pesha e kësaj shpate është 1.3 kg dhe bashkë me këllëfin është 3.2 kg.

Shpata tjetër është me dorezë lëkure shagreni, ka në anët e jashtme katër arabeska të thella, tre rrypa për hijeshi. Shpata është e përkulur në formë harku, gjatësia e saj është 121 cm dhe doreza është e zbukuruar me ar dhe lëkurë. Pesha e gjithë shpatës është 3.2 kg.



Dekorimi i z. Brandstetter nga Presidenti Nishani



Sjellja e Armëve të Skënderbeut me mbështetjen e SIGAL UNIQA



Investim në një prej ndërtesave tradicionale të Beratit, aset i SIGAL UNIQA



Vizita e gazetareve austriakë në Shqipëri



Konferenca Rajonale Vjetore 2012




Celebrimi i 13 vjet suksese

Harta e mbulimit	5	5	Broad Coverage
Fjala Përshëndetëse	6	44	Forewords
Vlerat dhe parimet tona	11	49	Our values and principles
Aksionerët tanë	11	49	Our shareholders
Ngjarje të rëndësishme gjatë vitit 2012	12	50	Important events during the year
Përgjegjësia jonë shoqërore	15	53	Our social responsibility
Skuadra SIGAL UNIQA	17	55	SIGAL UNIQA Team
Të fokusuar tek shëndeti	18	56	Focused at healthcare
Produkte të reja	19	57	New products
Të dhëna financiare	21	59	Financial data
Tregu i sigurimeve në rajon	24	62	Regional insurance market
Raporti i Auditit	27	27	Audit's Report
Kontaktet	64	64	Contacts

Harta e mbulimit Broad Coverage

- Drejtoria e Përgjithshme / Headoffice UNIQA Group
- SIGAL UNIQA Group Austria
- UNIQA Group



Të dashur zonja dhe zotërinj. Të dashur klientë, Të dashur partnerë biznesi,



Andreas Brandstetter
CEO, UNIQA Group Austria
Kryetar, Bordi Mbikëqyrës i SIGAL UNIQA

Ne besojmë se sukcesi iu vjen atyre që ndjekin një strategji të qartë dhe e zbatojnë në mënyrë konsistente atë. Kjo është pikërisht ajo që ne bëjmë: fokusohemi vazhdimisht në tregjet tona në Austri dhe në Europën Qendrore-Lindore (EQL).

Grupi ynë dëshiron të përdorë potencialin jashtëzakonisht të madh që rajoni i EQL do të ofrojë në dekadat e ardhshme në mënyrë që deri në vitin 2020 të dyfishojë numrin e klientëve dhe deri në vitin 2015 të dyfishojë primet për të arritur vlerën 2,5 Miliardë Euro prime në këtë rajon. Vetëm për qëllime krahasimore vlen të përmendet fakti se në vitin 1997 UNIQA kishte mbi 1 milion klientë.

Përgjatë 13 viteve, deri në vitin 2012, ne e shumëfishuam këtë numër më shumë se 8 herë sepse shtuam numrin e klientëve të rinj edhe në Europën Qendrore dhe Lindore.

Këtu flasim për një treg me më shumë se 300 milion njerëz. Në mënyrë që të shfrytëzojmë këtë potencial, ne duhet të jemi prezent ne nivel lokal. Kjo është arsyeja se përse ne përforcojmë vazhdimisht prezencën tonë.

Një shembull i mirë i kësaj strategjie është SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e cila arriti një rezultat të jashtëzakonshëm brenda grupit UNIQA dhe do të vazhdojë shtrirjen e vet brenda këtij rajoni. Kjo është arsyeja se përse ne festuam me krenari 5-vjetorin e një bashkëpunimi të shkëlqyer dhe duke u fokusuar tek e ardhmja, jam i sigurt se do të kemi të tjera evente të cilat do 'të çojnë përpara anijen tonë'.

Bashkëpunimi mes SIGAL dhe UNIQA, si aksioneri më i madh i tij, është bazuar gjithmonë në pozicionin e liderit që SIGAL ka si dhe në besimin e fortë për të një të

Rritja nuk pret: ne jemi të vendosur të përdorim mundësitë që dalin dhe po punojmë për përmbushjen e synimeve tona në vitet në vijim.

ardhme ekonomike pozitive të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë.

Ky bashkëpunim nuk mbështetet vetëm mbi fakte financiare dhe ekonomike por gjithashtu mbi përfshirjen e madhe ndër-personale të gjithë rajonit dhe të njerëzve. Me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, UNIQA, SIGAL dhe FSHAN mbështetën iniciativën për sjelljen e armëve të Skënderbeut në origjinë.

Rritja nuk pret: ne jemi të vendosur të përdorim mundësitë që dalin dhe po punojmë për përmbushjen e synimeve tona në vitet në vijim.

Do doja të falënderoj veçanërisht CEO-n tonë, Avni Ponari i cili përfaqëson bordin drejtues të SIGAL UNIQA, të gjithë punonjësit dhe partnerët tanë të biznesit për përkushtimin, dedikimin dhe kontributin e madh personal

për realizimin e një viti 2012 të suksesshëm dhe me shumë arritje.

Andreas BRANDSTETTER
CEO, UNIQA Group Austria
Kryetar i Bordit Mbikëqyrës,
SIGAL UNIQA Group Austria

Të dashur miq dhe partnerë të SIGAL UNIQA,



Avni Ponari
CEO, SIGAL UNIQA Group Austria
Anëtar, Bordi Mbikëqyrës SIGAL UNIQA

Të ndaj me ju rezultatet pozitive dhe performancën e mirë të grupit SIGAL UNIQA është një mënyrë për tju falënderuar që ishit me ne përgjatë vitit 2012. Së bashku shënuam arritje të reja, të një interesi dy-palësh ndaj jam shumë i kënaqur të përmend disa prej tyre.

Grupi SIGAL UNIQA pati një rritje të volumit të primeve prej rreth 5.84% duke arritur një total primesh prej 39 Milionë Euro.

Sërish lider të tregut

Për të dhjetin vit radhazi u renditëm të parët në tregun shqiptar të sigurimeve për të dy segmentet e sigurimeve (jetë dhe jo-jetë) si dhe në tregun e pensioneve private suplementare. Një tregues shumë i rëndësishëm është fakti që vazhdojmë të jemi të parët në pagesën e dëmeve duke paguar më shumë se 40% të dëmeve totale të gjithë tregut. Ky është fakti më i rëndësishëm për ne, njëkohësisht një synim dhe një vlerësim pasi përmbushja e përgjegjësisë kontraktuale ndaj klientëve tanë është filozofia bazë që prej themelimit.

Forcuam prezencën në rajon

Që prej disa vjetësh, SIGAL UNIQA është shndërruar në një grup të madh në të cilin përfshihen 8 kompani sigurimi. Vetëm një vit pas themelimit, 3 kompanitë e reja (Fondi i Pensioneve SIGAL, SIGAL Life UNIQA Kosova dhe UNIQA Life Shkup), dhanë rezultate pozitive duke mundësuar një përfundim të mëtejshëm të pozitave tona në tregun shqiptar, kosovar dhe maqedonas të sigurimeve. Nisur veçanërisht nga produktet novatore të sigurimeve të jetës dhe pensioneve private që këto kompani ofrojnë, pritshmëritë për performancën e tyre janë shumë pozitive.

Promoviam Shqipërinë

Në 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, me krenari mbështetëm sjelljen për herë të parë të Armëve të Heroit tonë Kombëtar. Pas shumë bisedave të detajuara me autoritetet austriake, së bashku me UNIQA-n ia dolëm që të kishim në Shqipëri reliket e Skënderbeut të cilat ishin larguar nga vendi më shumë se 5 shekuj më

Suksesi është rezultat i bashkëpunimeve frytdhënëse që kanë bazën tek forcimi i besimit reciprok, i përkushtimit dhe profesionalizmit.

parë. Rugëtimi i koleksionit të plotë me vlerë 35 Milionë Euro u finalizua me ceremoninë e hapjes së ekspozitës për publikun në datë 22 Nëntor 2012 duke shënuar një datë shumë të veçantë dhe emocionuese për ne si garantues dhe sigurues.

Një tjetër ngjarje e veçantë e vitit ishte vizita e një grupi gazetarësh austriakë, një nismë e UNIQA Group AUSTRIA e cila organizoi për të disatën herë një aktivitet që synon promovimin e vlerave shqiptare. Vizita ishte një sukses edhe për faktin se pati jehonë shumë pozitive në mediat më të mëdha të Austrisë.

Sollëm produkte të reja

Synimi ynë ka qenë gjithmonë që të jemi një hap përpara edhe përsa i përket prezantimit të produkteve të reja. Ishim të parët që sollëm në Shqipëri sigurimin privat të shëndetit dhe të jetës duke formësuar në këtë mënyrë edhe mentalitetin e publikut për domosdoshmërinë e këtyre sigurimeve. Veçantia e këtij viti ishte prezantimi i disa produkteve sigurimi për emigrantët si dhe i produkteve specifike të sigurimit të shëndetit dhe të makinës.

Të fokusuar tek e ardhmja

Rezultatet pozitive të muajve të parë të 2013-ës janë treguesit e parë të një tjetër viti të suksesshëm i cili do të sjellë gjithashtu sfida të reja për tu kapërcyer. Paralelisht me synimin për të qenë kompania më e besuar për shqiptarët në të tre shtetet ku operojmë, gjatë këtij viti do të fokusohemi tek ofrimi i të tjera produkteve bazuar tek nevojat e klientëve dhe zgjerimi i aktivitetit për kompanitë e reja.

Gjithmonë e më shumë bindem se suksesi është rezultat i bashkëpunimeve frytdhënëse që kanë bazën tek forcimi i besimit reciprok, i përkushtimit dhe profesionalizmit. Idetë dhe vizioni i qartë që kemi për të ardhmen dhe gjetja e partnerëve kyç kanë bërë të mundur që të shndërrohemi në grupin më të madh të sigurimeve në rajon ndaj falënderoj klientët, partnerët dhe punonjësit për besimin e treguar.

Avni Ponari
CEO, SIGAL UNIQA Group Austria
Anëtar, Bordi Mbikëqyrës SIGAL UNIQA



Promovojmë Shqipërinë!

Pikturë në vaj e Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, pjesë e koleksionit i cili u ekspozua në Muzeun Historik Kombëtar me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë. Me krenari, SIGAL UNIQA mbështeti sjelljen e koleksionit për herë të parë në Shqipëri pas gati 500 vjetësh.

VLERAT DHE PARIMET TONA

Cilësia

Ofrimi i një shërbimi cilësor që të përmbushë nevojat e klientëve është fjala kyçe e aktivitetit tonë. Jemi Kompania më e madhe dhe më e besueshme e sigurimeve për shqiptarët të cilët kanë vlerësuar maksimalisht cilësinë e shërbimit.

Respekti

Respekti për nevojat, mirëqenien dhe opinionin e klientëve, punonjësve dhe partnerëve tanë janë në qendër të vendimeve që marrim çdo ditë. Ne tregojmë respekt në çdo hap që hedhim duke filluar nga dizejimi i produkteve, strukturave dhe proceseve.

Mirësjellja

Ne besojmë se komunikimi është çelësi i suksesit për çdo kompani ndaj sjellja profesionale dhe korrekte si brenda Kompanisë ashtu edhe me partnerët dhe klientët është shumë e rëndësishme për ne. Ne i mbajmë dhe i zhvillojmë marrëdhëniet mbi bazën e besimit ndaj fokusohemi në gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme.

Harmonia

Ne i kushtojmë shumë rëndësi bashkëpunimit mes të gjithë aktorëve në punën tonë: klientëve, autoriteteve mbikëqyresve, aksionerëve dhe stafit. Organizimi që kemi është në funksion të një komunikimi të mirë së brendshmi dhe njëkohësisht në përputhje me kërkesat dhe dinamizmin e një tregu që zhvillohet dita-ditës.

Zhdërvjelltësia

Në punën tonë të përditshme nxitemi nga dëshira për tu ofruar vlera klientëve tanë dhe një mjedis pune të kënaqshëm për stafin tonë. Bazuar në këtë, jemi vazhdimisht të vëmendshëm ndaj opinionit dhe nevojave të tyre duke përshtatur shërbimin tonë.

AKSIONERËT TANË



UNIQA

UNIQA GROUP AUSTRIA

UNIQA Group Austria është aksioneri më i madh i SIGAL UNIQA.

UNIQA Group është aksioner i SIGAL UNIQA që nga muaji Mars i vitit 2007 dhe zotëron 68.64% të aksioneve.

UNIQA Group Austria është një nga grupet më të fuqishme financiare në Europën Qëndrore dhe Lindore, nën emrin e së cilës përfshihen 40 kompani sigurimi që operojnë në 21 shtete. UNIQA Group AUSTRIA është vlerësuar në vijimësi nga 'Standard&Poor's' me "A".



Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve

F.SH.A.N zotëron 13.3% të aksioneve të SIGAL dhe është aksioner i kompanisë që nga Tetori i vitit 2003.

Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve është themeluar me iniciativë dhe vendim të Kongresit Amerikan në vitin 1995 në kuadër të marrëveshjes "Për Demokracinë e Europës Lindore". Qëllimi kryesor i F.SH.A.N është të promovojë zhvillimin e ekonomisë në këto vende.

Investitorë vendas

18.06% e aksioneve të SIGAL UNIQA i përkasin investitorëve shqiptarë, njëkohësisht themelues të Kompanisë.



Presidenti Nishani dekoroi CEO-n e UNIQA Group AUSTRIA me "Medaljen e Mirënjohjes"

Medalja iu akordua z. Andreas Brandstetter, CEO i UNIQA Group AUSTRIA njëkohësisht Kryetar i Bordit Mbikqyrës të SIGAL UNIQA, me motivacionin "Për kontribut të rëndësishëm në krijimin dhe fuqizimin e tregut të sigurimeve në Shqipëri; për rolin e veçantë në përmirësimin e vazhdueshëm të legjislacionit lidhur me këtë treg dhe ndihmesë të vyer në disa evenimente të rëndësishme në festimet e 100 Vjetorit të Pavarësisë".

z. Brandstetter është ideatori dhe iniciuesi i marrëveshjes me SIGAL si dhe i disa aktiviteteve të rëndësishme të cilat kanë promovuar Shqipërinë në Europë të tilla si: Konferenca e CEO-ve (2009) dhe Vizita e gazetarëve Austriakë (2012) si dhe mbështeti sjelljen e Armëve të Skënderbeut në Shqipëri.

UNIQA Group AUSTRIA, si një ndër investitorët strategjikë në tregun shqiptar të sigurimeve, është ndër financuesit më të rëndësishëm të huaj jo vetëm për SIGAL UNIQA por për të gjithë tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon pasi ka kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të tij duke mundësuar mbështetje të fuqishme financiare, menaxheriale, njohuri të shumta për produkte novatore sigurimi që i nevojiten publikut shqiptar, të gjitha këto falë eksperiencës 130 vjecare të UNIQA.

Armët e Skënderbeut erdhën për herë të parë në Shqipëri me mbështetjen e SIGAL UNIQA

Në datë 22 Nëntor u zhvillua në Muzeun Historik Kombëtar ceremonia e hapjes së ekspozitës 'Armët e Skënderbeut' në të cilën u ekspozuan për herë të parë për publikun shqiptar përkrenarja, 2 shpatat, gravura e përmasave të mëdha dhe kodeksi i jetës së Skënderbeut. Gjatë 45 ditëve që qëndroi e hapur, ekspozita u vizitua nga rreth 1,7 Milionë persona.

Koleksioni, me vlerë 35 Milionë Euro, u sigurua nga SIGAL UNIQA. Sigurimi i një pasurie të tillë me vlera të mëdha historike për Shqipërinë është në përputhje me strategjinë e SIGAL UNIQA për mbrotjen e trashëgimisë kulturore dhe historike duke e siguruar atë.

Armët janë pjesë e koleksionit të Muzeut të Historisë së Artit Vjenë. Shpata dhe Përkrenarja e Skënderbeut përmenden për herë të parë në vitin 1593 në inventarin e koleksionit Ambraser të Ferdinandit II. Arqiduka Ferdinand II i Tirolit (1529-1595) ishte një koleksionist i apasionuar i armatimeve. Për Ferdinandin II Skënderbeu ishte mjaft i rëndësishëm, sepse pas fushbetes së tij të suksesshme të vitit 1556 kundër turqve në Hungari ai e shihte veten si një pasardhës të drejtëpërdrejtë të Skënderbeut. Që prej viteve 1580 Armët e Skënderbeut nuk janë larguar asnjëherë nga territori austriak.

Konferenca Rajonale

Në datat 8-10 Qershor SIGAL UNIQA organizoi në Dhërmi Konferencën Rajonale në të cilën morën pjesë z. Andreas Brandstetter, CEO i UNIQA Group AUSTRIA, përfaqësues të aksionerëve, Bordi Drejtues dhe stafi i 8 kompanive SIGAL UNIQA në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

Krahas të dhënave financiare, gjatë konferencës u analizuan gjithashtu, problemet, sfidat dhe synimet për të ardhmen si dhe u prezantua struktura e re për secilën nga kompanitë.



Vizita e gazetarëve austriakë

Një grup gazetarësh, përfaqësues të televizioneve dhe gazetave më të mëdha austriake, vizituan Shqipërinë në datat 1-3 Mars 2012, mbështetur nga UNIQA dhe SIGAL UNIQA. Përmes vizitës në Tiranë, Shkodër dhe Krujë, grupi i gazetarëve u njoh me nga afër me trashëgiminë kulturore të Shqipërisë si dhe disa nga atraksionet kulturore të vendit për turistët. Gjithashtu, ata u njohën me nga afër me zhvillimet ekonomike dhe ecurinë e vendit drejt B.E përmes takimeve me Kryeministrin Berisha dhe Kryetaren e Kuvendit, znj. Topalli. Gjatë vizitës, grupi i gazetarëve u ndal në zyrat qendrore të SIGAL UNIQA për tu njohur me arritjet e saj dhe zhvillimet e tregut shqiptar të sigurimeve në të cilin kanë investuar kompani të mëdha austriake si UNIQA Group AUSTRIA.

Vizita u pasqyrua gjerësisht në mediat austriake duke promovuar në këtë mënyrë ekonominë dhe kulturën e Shqipërisë me synimin për ti dhënë një shtytë të mëtejshme investimeve austriake në vend.



5 vjetori i hyrjes së UNIQA

UNIQA Group AUSTRIA hyri 5 vjet më parë në tregun shqiptar të sigurimeve përmes blerjes së aksioneve të kompanisë më të madhe të sigurimeve në vend SIGAL. Marrëveshja fillestare u firmos në 23 Mars 2007 për blerjen e 45.64% të aksioneve dhe u përforcua dy vjet më vonë (Nëntor 2009) me blerjen e 23% aksione të tjera duke bërë UNIQA Group AUSTRIA-n aksionerin më të madh të SIGAL.

Partneriteti me UNIQA i ka mundësuar SIGAL dhe të gjithë tregut shqiptar të sigurimeve një mbështetje të fuqishme në saj të eksperiencës si një prej kompanive lider të sigurimeve në Europë.

Investimi në SIGAL është konsideruar një histori suksesi nga UNIQA Group AUSTRIA e cila operon në 21 shtete evropiane.

PËRGJEGJËSIA JONË SHOQËRORE NË MBËSHTETJE TË...

Mbështesim



Nxsisim



Promovojmë



Vlerësojmë



...kujdesit shëndetësor

Sloganin tonë 'Shëndeti vjen i pari' e aplikojmë jo vetëm në ofrimin e paketave të sigurimit shëndetësor por edhe duke mbështetur projekte projekte dhe aktivitete të cilat kanë në fokus përmirësimin e shëndetit. Ndër këto aktivitete, përmendim Simpoziumin Shkencor për Pediatri të Hematologjike/Onkologjike i organizuar nga Fondacioni 'Fëmijët Shqiptarë'. Gjithashtu, në Klubin tonë të Shëndetit, njerëz të shumtë kryejnë vazhdimisht ekzaminime të gjendjes shëndetësore dhe teste fitnes të cilat ofrohen vetëm në Klubin e Shëndetit SIGAL.

...edukimit

SIGAL UNIQA është partner i universiteteve publike dhe private në vend duke marrë pjesë aktivisht në panairët e punës dhe seminare të ndryshme si dhe përmes ofrimit të praktikave mësimore në zyrat qendrore. Panairët e punës të zhvilluara nga universitete të ndryshme kanë qënë në fakt prezantimi i parë me disa të rinj të cilët tashmë janë pjesë e stafit SIGAL UNIQA.

...trashëgimisë kulturore

Ne besojmë thellësisht tek vlerat kulturore dhe trashëgimia e vendit tonë. Në këtë kuadër, në vitin 2012 restauruam një prej shtëpive tradicionale në lagjen Mangalem, Berat, aset i SIGAL UNIQA. Tashmë të kthyer në identitetin dhe imazhin që meritojnë, këto ndërtesa tipike janë përfshirë sërish në listën e atraksioneve kulturore që ofrojnë këto qendra të rëndësishme të turizmit shqiptar.

...muzikës & letërsisë & pikturës

Që prej 3 vjetësh Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA ka shërbyer për promovimin e shumë artistëve të rinj dhe të afirmuar në

fushën e letërsisë, muzikës dhe arteve pamore. Gjatë vitit 2012 në Klubin e Artit janë zhvilluar dhjetëra aktivitete kulturore ndër të cilat ekspozita pikturë, mbrëmje muzikore, portrete artistësh, promovime librash dhe seminare me tematika të ndryshme.

Krahas këtyre, SIGAL UNIQA ka mbështetur aktivitete të shumta kulturore ndër të cilat koncertin Different Trains Festival i cili solli në Shqipëri violinistin e mirënjohur Tedi Papavrami dhe muzikantë të tjerë të njohur ndërkombëtarisht, shqiptarë dhe të huaj. Me dëshirën për ti dhënë një shtysë muzikës në Shqipëri, kemi mbështetur projekte të artistëve të rinj të cilët kanë filluar suksesshëm karrierën e tyre artistike si në rastin e Evis Mulës, mbrëmja lirike e së cilës mori mbështetjen e SIGAL UNIQA. Një tjetër veçanti e këtij viti ishte realizimi dhe promovimi i librit biografik të imazhit të SIGAL UNIQA, Aktorit të Popullit Reshat Arbana i vlerësuar nga Presidenti i Republikës me titullin 'Nderi i Kombit'.

...sportit

Që prej disa vjetësh, jemi sponsor i skuadrave të ndryshme të basketbollit, futbollit dhe sporteve ujore. Dy ndër skuadrat e mbështetura nga SIGAL UNIQA, skuadrat SIGAL Prishtina (për meshkuj dhe për femra) u shpallën fituese të kampionatit të basketbollit në Kosovë. Gjithashtu në 2012-ën, u fokusuam edhe tek një zhanër tjetër sportiv si alpinizmi: mbështetëm ekspeditën e parë shqiptare në "çatinë e botës"-malin Everest si dhe ekspeditën kosovare në malin Kaçkalar, mali i katërt më i madh në Turqi.



Ne vlerësojmë artin duke e siguruar atë!

Portret i Ismail Bej Vlorës, pikturë me vaj në kanvas i piktorit Elton Valle. Piktura me vlerë disa mijëra euro, pjesë e një koleksioni privat, u sigurua nga SIGAL UNIQA.



Më 22 Shkurt 2012 festuam 13 vjetorin në Teatrin Skampa i cili u rikonstruktua falë dëmshpërblimit të SIGAL UNIQA.

Me përgjegjshmëri përmbushim detyrimet tona kontraktuale: kjo ka qenë baza e punës sonë që prej themelimit dhe do të jetë angazhimi kryesor për të ardhmen!



Mbrojmë dhe mbështesim trashëgiminë kulturore!

Një prej ndërtesave karakteristike të Beratit e cila ndodhet në hyrjen e lagjes Mangalem, u rikonstruktua duke i sjellë sërish shkëlqimin e mëparshëm. Kjo ndërtesë është aset i SIGAL UNIQA ku zhvillon aktivitetin Dega Berat.

SKUADRA SIGAL UNIQA



Skuadra jonë përbëhet nga mijëra punonjës dhe agjentë që punojnë në zyrat e administrimit dhe shitjes në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Qëllimi ynë është ofrimi i një shërbimi cilësor dhe këshillim për të gjithë klientët dhe partnerët tanë. Gjatë vitit 2012, grupit SIGAL UNIQA iu shtuan edhe 50 profesionistë të tjerë me eksperiencë në sigurime duke rritur edhe më shumë cilësinë e shërbimit në çdonjërin prej zyrarëve të SIGAL UNIQA.

Stabilitetin në skuadrën tonë e vërteton fakti që 60% e stafit është pjesë e SIGAL UNIQA që prej 5 vjetësh. Kjo eksperiencë dhe trajnimet e vazhdueshme për punonjësit më të rinj, bëjnë të mundur që secili prej nesh të ketë një njohje më të mirë të produkteve dhe klientëve.

Kultura e punës

Objektiviteti, profesionalizmi dhe korrektësia janë fjalët kyçe që karakterizojnë punën e gjithësecilit. Në punën tonë të përditshme udhëhiqemi nga disa parime bazë si: cilësia, respekti, mirësjellja, harmonia dhe fleksibiliteti. Mbi bazën e këtyre parimeve, ofrojmë çdo ditë jo thjesht polica sigurimi por asistencë të plotë për të gjithë klientët tanë të cilët që prej 10 vjetësh na kanë cilësuar si kompaninë me të madhe dhe më të besuar të sigurimeve në vend.

Marrëdhënia me klientët

Skuadra SIGAL UNIQA i shërben suksesshëm më shumë se 500,000 klientëve të cilët na kanë zgjedhur për më shumë siguri për veten dhe familjet e tyre. Çdo klient i SIGAL UNIQA ka në dispozicion të nevojave të veta jo thjesht një punonjës por një këshilltar personal financiar i cili ofron zgjidhjet e përshatshme në funksion të një sigurie dhe mbrojtjeje maksimale.

Komunikimi i drejtpërdrejtë dhe transparent me klientët bën të mundur përditësimin e informacionit për nevojat e tyre duke forcuar në këtë mënyrë marrëdhënien e çdo punonjësi të SIGAL UNIQA me klientët.

Trajnimi dhe motivimi

Tregu i sigurimeve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni po zhvillohet me një dinamikë të lartë duke sjellë sfida të reja për tu kapërcyer. Përballë këtyre sfidave, trajnimi i vazhdueshëm i stafit në Austri dhe institucione të ndryshme brenda dhe jashtë Shqipërisë, bën të mundur që të jemi gjithmonë një hap përpara në drejtim të ofrimit të zgjidhjeve për çështje të ndryshme.

Krahas kësaj, skemat e bonuseve dhe incentivave, mundësitë reale për rritje në karrierë janë të tjera masa të marra të cilat garantojnë përkushtimin maksimal të punonjësve tanë.

TË FOKUSUAR TEK SHËNDETI!

Pesë vjet më parë sollëm për herë të parë në Shqipëri Sigurimin Privat të Shëndetit dhe sot mijëra familje shqiptare kanë zgjedhur të sigurohen tek SIGAL UNIQA. Duke marrë një kontratë sigurimi shëndeti, SIGAL UNIQA paguan faturat për çdo trajtim mjekësor në përputhje me paketën shëndetësore të zgjedhur. Në këtë mënyrë, sigurimi është një mënyrë shumë e mirë për të mbajtur në ekuilibër si shëndetin ashtu edhe financat tona. Sigurimi i shëndetit ofron mbulim të shpenzimeve nga sëmundjet dhe aksidentet me apo pa shtrim në spital, kontrollet diagnostikuese, medikamentet deri tek emergjencat dentare dhe transporti me ambulancë.

Paketa shëndetësore Standard (fleksibël)

Është zgjidhja ideale për të përfituar shërbimin shëndetësor në spitale dhe klinika në Shqipëri. Përmes kësaj pakete, mbulohen shpenzimet mjekësore deri në 10,000-50,000 Euro/vit. Përmes paketës Standard, krahas check-up vjetor, shpenzimeve mjekësore me apo pa shtrim në spital mbulohen shpenzimet për medikamentet e rekomanduara nga mjeku deri në 500 Euro/vit.

Paketa shëndetësore e Argjendtë

Mundëson mbulimin e shpenzimeve për shërbime mjekësore në vend, Austri, Turqi, Kosovë dhe Maqedoni deri në 150,000 Euro/vit. Përmes paketës së Argjendtë, krahas check-up vjetor, mbulohen 100% shpenzimet spitalore, kemioterapi dhe radioterapi, kiurgjia dirore dhe kontrollet diagnostikurse me rreze X si dhe medikamentet e rekomanduara nga mjeku deri në 1000 Euro/vit. Gjithashtu, paketa e Argjendtë mbulon shpenzimet e riadhesimit dhe evakuim mjekësor me ambulancë ajrore të specializuar, deri në 15,000 Euro/vit.

Paketa shëndetësore e Artë

Mundëson përfitimin e shërbimeve shëndetësore deri në 500,000 Euro/vit në spitale dhe klinika thuajse në të gjithë botën (përfshirë SH.B.A, Kanada, Zvicër, Japoni dhe Hong-Kong). Paketa e Artë mbulon në masën 100% shpenzimet spitalore, trajtimin me kimioterapi dhe radioterapi, kontrollet diagnostikuese me rreze X si dhe kujdesin parandalues deri në 4000 Euro/vit. Gjithashtu,

paketa e Artë e sigurimit ofron mbulim të shpenzimeve për emergjencat dentare deri në 350 Euro/vit dhe rimbursim për medikamentet të këshilluara nga mjeku deri në 2000 Euro/vit.

Sigurim shëndetësor për shtetasit e huaj që jetojnë në Shqipëri.

Paketa e sigurimit për shtetasit e huaj që jetojnë në Shqipëri ofron 100% mbulim të shpenzimeve mjekësore si pasojë e një sëmundje akute apo aksidenti, me shtrim apo shtrim në spital.

Pse sigurim shëndeti tek SIGAL UNIQA?

- Paketa sigurimi që ofrojnë mbulim 100% të faturës;
- **Fleksibilitet:** paketat e sigurimit shëndetësor të SIGAL UNIQA mund të përshtaten për familje dhe grupe individësh/punonësish në varësi të nevojave dhe mundësive të gjithkujt.
- **Ekspierencë:** Sigurimi privat I shëndetit erdhi për herë të parë në Shqipëri nga UNIQA Group AUSTRIA, një kompani ndërkombëtare sigurimi me mbi 130 vjet ekspierencë. UNIQA Group AUSTRIA është aksioneri më i madh i SIGAL UNIQA dhe si i tillë ka mundësuar mbështetje financiare dhe njohuri në lidhje me sigurimin privat të shëndetit.
- **Rrjet i gjerë klinikash dhe spitalesh në të gjithë botën:** për tu ofruar një shërbim shumë cilësor dhe asistencë të shtrirë gjeografikisht, SIGAL UNIQA bashkëpunon me qindra klinika dhe spitale të cilat janë pjesë e rrjetit të saj dhe kanë shtrirje në të gjithë botën. Në Shqipëri, klinikat dhe spitalet më të mira private janë pjesë e rrjetit shëndetësor SIGAL UNIQA.
- **Asistencë në gjuhën shqipe 24 orë.** Në dispozicionin tuaj është një numër telefonik pa pagesë për tju ofruar ndihmën e nevojshme në çdo moment;
- **Lehtësim të procedurave:** SIGAL mundëson organizim të takimeve me klinikën/spitalin, lëshimin e garancisë së pagesës etj;
- **Çdo i siguruar ka mundësinë të zgjedhë vetë klinikën apo spitalin ku kërkon të marrë shërbim mjekësor.**

PRODUKTE TË REJA



Karta VITAL

Në vitin 2012 SIGAL UNIQA solli Kartën Vital, një produkt i ri në bashkëpunim me Spitalin Amerikan. Karta Vital është një paketë sigurimi shëndetësor përmes së cilës mbulohen shpenzimet mjekësore në rast aksidenti ose sëmundje deri në 5000 Euro, sigurimi i jetës në rast aksidenti deri në 5000 Euro si dhe një kontroll vjetor rutinë falas.

E veçanta e Kartës Vital është se ofrohet individuale ose familjare, çfarë do të thotë se të gjithë anëtarët e familjes përfitojnë shërbimet mjekësore në të gjitha degët e Spitalit Amerikan në Shqipëri dhe Kosovë përmes një karte të vetme.

MINIKASKO

Është sigurimi i vetë automjetit për dëmtimet aksidentale nga përplasja e tij me një automjet tjetër, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të vërtetuar me proces verbalin e policisë.

Përmes sigurimit MINIKASKO mundësohet dëmshpërblim i menjëhershëm nga SIGAL UNIQA në rast aksidenti me një mjet tjetër, pavarësisht se kush është shkaktari i aksidentit (i cili mund të jetë ose jo klient i SIGAL UNIQA). SIGAL UNIQA vlerëson dëmin e automjetit dhe klientët dëmshpërblehen menjëherë pa patur nevojë të presin dëmshpërblimin e kompanisë përgjegjëse.

PAKETA PËR EMIGRANTËT

Sigurimi i shëndetit

Përmes Sigurimit të Shëndetit për Emigrantët, SIGAL UNIQA iu ofron emigrantëve mundësinë për të marrë shërbim mjekësor në Shqipëri, me të njëjtën cilësi si në vendin ku jetojnë.

Sigurimi i shëndetit për emigrantët mbulon të gjitha shpenzimet mjekësore në klinikat dhe spitalet private në Shqipëri dhe në një shtet të huaj sipas zgjedhjes së vetë personit (Greqi, Itali, Gjermani dhe Maqedoni).


Pension privat për emigrantët

Fondi i Pensioneve Private SIGAL Life UNIQA ka prezantuar për emigrantët pensionin privat suplementar për veten apo për prindërit në Shqipëri.

Duke pasur parasysh se investimi për një pension privat është i sigurt dhe me interes të lartë, përfitimi është gjithashtu më i madh në krahasim me skemat shtetërore. Kontributi mund të paguhet në baza mujore, tremujore, gjashtëmujore, dhe vjetore ose në formën e një pagesë të vetme për të gjithë periudhën.

Ndërkohë që shuma e akumuluar mund të merret në formën e një pensioni privat shtesë çdo muaj ose formën e një pagese të vetme.

TË DHËNA FINANCIARE

Grupi SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA
Prime të shkruara për tre vitet e fundit


Kompania	2010 (në Euro)	2011 (në Euro)	2012 (në Euro)
SIGAL UNIQA AL Jo-Jetë dhe Risigurime	16,651,297	17,133,284	17,598,129
SIGAL Life UNIQA AL	3,209,566	3,645,281	3,228,050
SIGAL Life UNIQA SH.A.F.P*	-	576,615	961,625
SIGAL UNIQA KS Jo-Jetë	7,501,594	8,368,689	9,222,743
SIGAL Life UNIQA KS*	-	5,000	188,126
UNIQA MK Jo-Jetë	6,720,349	7,538,356	8,041,964
UNIQA Life MK*	-	218,173	672,530
GRUPI	34,082,806	37,485,397	39,913,167

* SIGAL Life UNIQA SH.A.F.P ka filluar veprimtarinë më 30 Mars 2011. Të dhënat për Fondin janë progresive.

* SIGAL Life UNIQA KS ka filluar veprimtarinë më Shtator 2011.

* UNIQA Life MK ka filluar veprimtarinë më Maj 2011.

Prime të shkruara sipas produkteve për vitin 2012



Nr	Lloji i Produktit	AL	KS	MK	Grupi
1	Pasuri	6,201,426	1,503,456	994,754	8,699,636
2	M. Motorike	8,965,544	6,359,711	6,444,719	21,769,974
3	Jetë, Shëndet dhe Aksidente	5,270,148	1,518,924	1,207,790	7,996,861
4	Marinë dhe Aviacion	173,004	28,021	62,921	263,945
5	Pensione Vullnetare*	961,625	-	-	961,625
6	Risigurime*	202,547	-	-	202,547
	Duplikate	13,510	758	4,310	18,579
TOTALI në Euro		21,787,804	18,633,613	16,756,457	39,913,167

* Produktet e Pensioneve vullnetare dhe Risigurimet ofrohen vetëm në Shqipëri përkatësisht nga kompanitë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Risigurime dhe SIGAL Life UNIQA SH.A.F.P.

Everest, 25 maj 2012




Së bashku, arrijmë maja të reja!

Ekspedita e parë shqiptare e cila ngjiti malin Everest. Flamuri shqiptar u valëvit në 'majën e botës' në datë 25 Maj 2012.

Si një kompani që synon rritjen dhe kapërcimin e sfidave të reja, SIGAL UNIQA mbështeti alpinistët të cilët mundësuan një tjetër veçanti në përvjetorin e rëndësishëm të Shqipërisë.

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA SHQIPËRI

Prime të shkruara sipas produkteve për vitin 2012



SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA JO JETË

Nr	Lloji i produktit	Euro
I	Pasuri	6,201,426
1	Zjarr	4,528,184
2	CAR	123,134
3	G. Oferte	60,691
4	G. Kontrate	283,251
5	G. Bankare	8,960
6	Banka CIS-CIT	225,872
7	Përgjegjësi	971,144
8	Bujqësi&Blegtori	190
II	M. Motorike	8,965,544
1	TPL	5,555,220
2	KASKO	1,422,514
	SUPER KASKO	6,533
3	Kufitare	756,823
4	K. Jeshil	1,224,454
III	Shëndet dhe Aksidente	2,042,098
1	Shën. Udhëtim	334,816
3	Aks. Personale	276,125
4	Aks. Nxënës	12,071
5	Aks. Sportistë	4,356
6	Shëndet Privat	1,400,842
7	Super Shëndet	1,489
8	Karta Vital	12,399
IV	Marinë&Aviacion	173,004
1	H & M	0
2	P & I	136,568
3	Mall në Transport	127,737
4	Avionë	-91,301
	TOTAL	17,382,071
V	DUBLIKATA	13,510
VI	RISIGURIME	202,547
	TOTAL	17,598,129

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA

Nr	Lloji i produktit	Euro
	SIG. JETËS	
1	Jeta e Kreditorit	2,262,160
2	Jete e Kombinuar	183,281
3	Jeta me Kursim	782,608
	TOTALI	3,228,050

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A.F.P

Nr	Lloji i produktit	Euro
	Pension Vullnetar*	
1	Të ardhura nga kontributet	914,288
2	Të ardhura nga Investimet	47,337
3	Të ardhura të tjera	-
	TOTAL	961,625


* Pensionet vullnetare ofrohen nga kompania SH.A.F.P e cila filloi veprimtarinë në 30 Mars 2011. Të dhënat për Fondin janë progresive.

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA KOSOVË

Prime të shkruara sipas produkteve për vitin 2012

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA JO JETË

Nr	Lloji i produktit	Euro
I	Pasuri	1,503,456
1	Zjarr	433,068
2	CAR	163,033
3	G. Oferte	97,684
4	G. Kontrate	288,016
5	G. Bankare	0
6	Përgjegjësi	311,636
7	Banka	210,020
8	Bujqësi&Blegtori	0
II	M. Motorike	6,359,711
1	TPL	4,490,243
2	Kufitare	1,259,412
3	TPL+	143,683
4	Mbulimi Plus	0
5	Kasko	466,373
6	K. Jeshil *	-
III	Shëndet dhe Aksidente	1,330,798
2	Sigurimi Shëndetësor	1,020,686
3	Shën. Udhëtim	205,730
4	Aks. Personale	95,285
5	Polica të nxënësve	250
6	PPI-Asset Protection	8,847
IV	Marinë&Aviacion	28,021
1	H & M	0
2	Mall në Transport	28,021
3	Avione	0
V	Dublikata	758
	TOTAL	9,222,743



SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA

Nr	Lloji i Produktit	Euro
	Sigurimet e Jetës*	
1	Jeta e Kreditorit	100,474
2	Jete e Kombinuar	-
3	Jeta me Kursim	87,653
	TOTALI	188,126


* SIGAL UNIQA KS nuk e ofron produktin e Kartonit Jeshil
* Sigurimet e jetës ofrohen nga kompania SIGAL Life UNIQA Kosova e cila ka filluar veprimtarinë në Shtator 2011.

UNIQA MAQEDONI

Prime të shkruara sipas produkteve për vitin 2012

UNIQA JO JETË

Nr	Lloji i produktit	Euro
I	Pasuri	994,754
1	Zjarr	780,154
2	CAR	76,031
3	Garanci	0
4	Përgjegjësi	138,569
5	Banka (Falsifikat)	0
II	M. Motorike	6,444,719
1	TPL	4,599,635
2	Kasko	656,121
3	Kufitare	71,267
4	K. Jeshil	1,117,696
III	Shëndet dhe Aksidente	535,260
2	Shëndet në Udhëtim	201,314
3	Aksidente	317,141
4	Udhëtar në transport publik	16,805
IV	Mall në Transport	62,921
1	Transport	39,617
2	Garanci TIR	0
3	CMR	23,303
V	Dublikata	4,310
	TOTAL	8,041,964




UNIQA LIFE

Nr	Lloji i Produktit	Euro
	Sigurimet e Jetës*	
1	Jeta e Kreditorit	0
2	Jete e Kombinuar	68,438
3	Jeta me Kursim	604,092
	TOTALI	672,530

* Sigurimet e jetës ofrohen nga kompania UNIQA Life Maqedoni e cila ka filluar veprimtarinë në Maj 2011.


TREGU I SIGURIMEVE NË RAJON



Tregu shqiptar i sigurimeve jo-jetë


Tregu i sigurimeve të jo-jetës, në të cilin operojnë 9 kompani, u udhëhoq nga SIGAL UNIQA e cila zotëroi 30.33% të tregut.

Si çdo vit, SIGAL UNIQA renditet gjithashtu e para edhe për pagesën e dëmeve duke paguar 31.39% të dëmeve.




Tregu shqiptar i sigurimeve të jetës

Që prej disa vjetësh, në tregun shqiptar të sigurimeve të jetës operojnë 3 kompani sigurimi. Edhe për vitin 2012 tregu u udhëhoq nga SIGAL Life UNIQA me 51.16% e cila ka paguar 52.9% të dëmeve të ndodhura në treg.




Tregu shqiptar i pensioneve private

Gjatë vitit 2012, në tregun e pensioneve operuan 3 fonde pensionesh private. Fondi i Pensioneve SIGAL udhëhoqi tregun si për numrin e kontribuesve (41.82%) ashtu edhe për totalin e kontributeve të derdhura.




Tregu kosovar i sigurimeve*

Në tregun kosovar operojnë 10 kompani sigurimi ndër të cilat SIGAL UNIQA Kosova renditet e treta me 13.82% të tregut për volumin e primeve si dhe ka paguar 10.05% të dëmeve totale të tregut.



Tregu maqedonas i sigurimeve

Në tregun maqedonas të sigurimeve të jo-jetës operojnë 12 kompani. UNIQA a.d u rendit ne vendin e shtatë për nga volumi i primeve të shkruara.



Ndërkohë që UNIQA Life renditet e treta në tregun maqedonas të sigurimeve të jetës në të cilin operojnë 5 kompani.

* Për tregun e sigurimeve të jetës në Kosovë nuk ka informacion nga Autoriteti Mbikëqyrës.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.
Pasqyrat Financiare të Konsoliduara
për vitin e mbyllur më
31 dhjetor 2012
(me raportin e audituesit bashkëlidhur)

*Consolidated Financial Statements
as at 31 December 2012
(with the independent auditor's report thereon)*

Raport i Audituesit të Pavarur

Aksionarëve të
SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.

Tirane, 28 maj 2013

Ne kemi audituar pasqyrat e konsoliduara financiare bashkëlidhur të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a. (“Grupi”), të cilat përbëhen nga pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar në datë 31 dhjetor 2012 si edhe pasqyra e konsoliduar e të ardhurave përmbledhëse, e ndryshimeve të kapitalit dhe e flukseve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për një kontroll të brendshëm, të tillë siç drejtimi vendos se është i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave të konsoliduara financiare pa anomali materiale, të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra të konsoliduara financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne t’u përmbahemi kërkesave etike të përshtatshme dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të fituar siguri të arsyeshme që pasqyrat e konsoliduara financiare nuk përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencë që mbështet shumat dhe informacionet shpjeguese të dhëna në pasqyrat e konsoliduara financiare. Procedurat e përzgjedhura janë në varësi të gjykimit tonë, përfshirë këtu vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat e konsoliduara financiare, prej gabimit apo mashtrimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, ne shqyrtojmë kontrollin e brendshëm, i cili është i rëndësishëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave të konsoliduara financiare, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por që nuk kanë për qëllim shprehjen e një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të njësisë ekonomike. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve kontabël të përdorura dhe të çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave të konsoliduara financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

Independent Auditors’ Report

To the shareholders of
SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.

Tirana, 28 May 2013

We have audited the accompanying consolidated financial statements of SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a. (“the Group”), which comprise the consolidated statement of financial position as at 31 December 2012, the consolidated statement of comprehensive income, changes in equity and cash flows for the year then ended, and notes, comprising a summary of significant accounting policies and other explanatory information.

Management’s Responsibility for the Financial Statements

Management is responsible for the preparation and fair presentation of these consolidated financial statements in accordance with International Financial Reporting Standards, and for such internal control as management determines is necessary to enable the preparation of consolidated financial statements that are free from material misstatements, whether due to fraud or error.

Auditors’ Responsibility

Our responsibility is to express an opinion on these consolidated financial statements based on our audit. We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing. Those standards require that we comply with relevant ethical requirements and plan and perform the audit to obtain reasonable assurance whether the consolidated financial statements are free of material misstatement.

An audit involves performing procedures to obtain audit evidence about the amounts and disclosures in the consolidated financial statements. The procedures selected depend on our judgment, including the assessment of the risks of material misstatement of the consolidated financial statements, whether due to fraud or error. In making those risk assessments, we consider internal control relevant to the entity’s preparation and fair presentation of the consolidated financial statements in order to design audit procedures that are appropriate in the circumstances, but not for the purpose of expressing an opinion on the effectiveness of the entity’s internal control. An audit also includes evaluating the appropriateness of accounting principles used and the reasonableness of accounting estimates made by management, as well as evaluating the overall presentation of the consolidated financial statements.

We believe that the audit evidence we have obtained is sufficient and appropriate to provide a basis for our opinion.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat e konsoliduara financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë për gjendjen financiare të konsoliduar të Grupit me datë 31 dhjetor 2012, për rezultatin e tij financiar të konsoliduar dhe flukset e tij monetare të konsoliduara për vitin e mbyllur në atë datë, në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

KPMG Albania Sh.p.k.

KPMG Albania Sh.p.k.
“Dëshmorët e Kombit” Blvd.
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana
Albania

Opinion

In our opinion, the consolidated financial statements give a true and fair view of the consolidated financial position of the Group as at 31 December 2012, and of its consolidated financial performance and its consolidated cash flows for the year then ended in accordance with International Financial Reporting Standards.

KPMG Albania Sh.p.k.

KPMG Albania Sh.p.k.
“Dëshmorët e Kombit” Blvd.
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana
Albania

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2012	31 dhjetor 2011
AKTIVET			
Mjete monetare në arkë dhe në bankë	9	351,922	409,510
Depozita me afat	10	5,112,353	5,099,602
Investime në letra me vlerë	11	841,003	310,094
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi	12	969,017	856,331
Aktive të risigurimit	13	240,604	205,478
Kostot e shtyra të marrjes në sigurim	14	458,309	443,992
Inventari		14,224	7,262
Tatim fitimi i parapaguar		27,689	663
Ndërtesa dhe pajisje	15	1,160,882	1,080,551
Aktive të tjera	16	231,647	108,753
TOTALI AKTIVEVE		9,407,650	8,522,236
DETYRIMET			
Detyrime për humbjet dhe shpenzimet për rregullimin e humbjes	17	2,493,379	2,242,812
Rezerva për primet e pafituara	17	2,527,643	2,388,445
Rezerva të tjera	17	250,517	127,871
Huatë	18	-	28,220
Fondi i pensionit	19	134,233	80,877
Llogari të pagueshme për sigurimin dhe risigurimin	20	193,657	173,096
Llogari të pagueshme të tjera	21	199,507	145,326
TOTALI I DETYRIMEVE		5,798,936	5,186,647
KAPITALI			
Aksione të zakonshme		2,232,909	2,232,909
Rezerva të tjera të kapitalit		52,133	52,133
Rezerva e sigurisë		389,238	324,840
Rezerva e përkthimit		101,148	91,075
Filime të akumuluar		821,831	630,164
Totali i kapitalit që i përket aksionerëve të Shoqërisë		3,597,259	3,331,121
Interesat e pakicës		11,455	4,468
TOTALI I KAPITALIT		3,608,714	3,335,589
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		9,407,650	8,522,236

Këto pasqyra të konsoliduara financiare janë aprovuar nga drejtimi i Grupit më 28 Maj 2013:

Avni Ponari
Drejtor i përgjithshëm



Klement Mersini
Shef i financës



SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.

Consolidated Statement of Financial Position

(All amounts are expressed in thousand Lek, unless otherwise stated)

	Notes	31 December 2012	31 December 2011
ASSETS			
Cash and cash equivalents	9	351,922	409,510
Term deposits	10	5,112,353	5,099,602
Investment in securities	11	841,003	310,094
Insurance receivables	12	969,017	856,331
Reinsurance assets	13	240,604	205,478
Deferred acquisition cost	14	458,309	443,992
Inventory		14,224	7,262
Current income tax asset		27,689	663
Property and equipment	15	1,160,882	1,080,551
Other assets	16	231,647	108,753
TOTAL ASSETS		9,407,650	8,522,236
LIABILITIES			
Liabilities for losses and loss adjustment expenses	17	2,493,379	2,242,812
Unearned premium reserve	17	2,527,643	2,388,445
Other reserve	17	250,517	127,871
Borrowings	18	-	28,220
Due to contributors	19	134,233	80,877
Insurance and reinsurance payables	20	193,657	173,096
Other payables	21	199,507	145,326
TOTAL LIABILITIES		5,798,936	5,186,647
EQUITY			
Ordinary shares	22	2,232,909	2,232,909
Other capital reserves		52,133	52,133
Insurance risk reserve	23	389,238	324,840
Translation reserves		101,148	91,075
Retained earnings		821,831	630,164
Total equity attributable to the Company's equity holders		3,597,259	3,331,121
Non-controlling interest		11,455	4,468
TOTAL EQUITY		3,608,714	3,335,589
TOTAL EQUITY AND LIABILITIES		9,407,650	8,522,236

These consolidated financial statements have been approved by the Directors of the Group on 28 May 2013:

Avni Ponari
General Manager



Klement Mersini
Chief of Finance



SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.
Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave përmblëdhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor
(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	2012	2011
Të ardhura nga primet	24	5,318,512	5,083,944
Prime ceduar risiguresit	25	(529,770)	(719,059)
Prime të shkruara neto		4,788,742	4,364,885
Ndryshimi neto në rezervën e primeve të pafituara	17	(133,601)	(322,573)
Ndryshimi neto në rezervën e risiguresit	13	(15,157)	140,634
Të ardhura neto nga sigurimi		4,639,984	4,182,946
Të ardhura nga investimet		189,316	168,416
Të ardhura të tjera	26	90,609	97,640
Të ardhura neto		4,919,909	4,449,002
Ndryshimi neto në rezerva të tjera	17	(122,646)	(59,530)
Ndryshimi nga risigurime të rikuperueshme	17	50,013	(2,581)
Dëme sigurimi dhe shpenzimet për rregullimin e humbjes të rikuperueshme nga risiguresit.	17	(1,935,496)	(1,869,529)
Dëme të sigurimit neto		(2,008,129)	(1,931,640)
Kostot e marrjes në sigurim	27	(787,176)	(654,084)
Shpenzime administrative dhe marketingu	28	(1,307,129)	(1,161,441)
Shpenzime të tjera sigurimi	29	(531,148)	(582,251)
Shpenzime		(4,633,582)	(4,329,416)
Fitimi operativ		286,327	119,586
Fitimi nga kursi i kembimit		(8,120)	38,753
Fitimi para tatimit		278,207	158,339
Tatimi mbi fitimin	30	(24,482)	(35,146)
Fitimi i vitit		253,725	123,193
Të ardhura/(humbje) të tjera përmblëdhëse		10,073	(5,371)
Totali i të ardhurave përmblëdhëse të vitit		263,798	117,822
Fitimi i kredituar tek:			
Kapital-Mbajtësit e Shoqërisë Mëmë		256,065	125,426
Interesat e pakicës		(2,340)	(2,233)

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.
Consolidated statement of comprehensive income for the year ended 31 December
(All amounts are expressed in thousand Lek, unless otherwise stated)

	Notes	2012	2011
Premium revenue	24	5,318,512	5,083,944
Premium ceded to reinsurers	25	(529,770)	(719,059)
Net written premium		4,788,742	4,364,885
Change in provision for unearned premium	17	(133,601)	(322,573)
Change in provision for reinsurers	13	(15,157)	140,634
Net earned premium		4,639,984	4,182,946
Investment income		189,316	168,416
Other income	26	90,609	97,640
Net income		4,919,909	4,449,002
Change in other reserve	17	(122,646)	(59,530)
Change in reinsurance recoverable	17	50,013	(2,581)
Insurance claims and loss adjustment expenses	17	(1,935,496)	(1,869,529)
Net insurance claims		(2,008,129)	(1,931,640)
Acquisition costs	27	(787,176)	(654,084)
Administration and marketing expenses	28	(1,307,129)	(1,161,441)
Other insurance expenses	29	(531,148)	(582,251)
Expenses		(4,633,582)	(4,329,416)
Operating Profit		286,327	119,586
Foreign exchange (losses)/gains		(8,120)	38,753
Profit before income tax		278,207	158,339
Income tax expense	30	(24,482)	(35,146)
Profit for the year		253,725	123,193
Other comprehensive income/(loss)		10,073	(5,371)
Total comprehensive income for the year		263,798	117,822
Profit attributable to:			
